

Mbrojtja e Liqenit të Ohrit

“DREJT NJË QEVERISJEJE TE PËRBASHKËT TË TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE NDËRKUFITARE TË RAJONIT TË LIQENIT TË OHRIT”

NË KËTË NUMËR:

- 1** - Vlerësim për projektin e Liqenit të Ohrit në Komitetin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO (faqe 1)
- 2** - BE për projektin (faqe 1)
- 3** - Kurs rajonal për promovimin e trashëgimisë me fokus njeriun (page 2)
- 4** - Mbështetja e Menaxhimit të duhur të mbetjeve në Bashkinë e Pogradecit (faqe 2)
- 5** - ICOMOS: Një propozim për të ruajtur ndërtesat tradicionale rreth liqenit të Ohrit (faqe 2)
- 6** - Takimi ndërkufitar në Strugë adreson menaxhimin e përbashkët të Liqenit të Ohrit (faqe 3)
- 7** - Shqipëria pranohet në Konventën Europiane të Peisazhit (faqe 3)
- 8** - Intervistë me Milovan Shutinoski, drejtor i Muzeut “Nikola Nezlobinski” në Strugë (faqe 4)
- 9** - Edicioni i 55-të i Festivalit Mbrëmjet e Poezisë në Strugë (faqe 4)
- 10** - Ekplorimi nënujor i Liqenit të Ohrit (faqe 5)
- 11** - Me biçkletë 360 gradë rreth liqenit më të thellë në Ballkan (faqe 5)
- 12** - Fosilet e peshqve në Pogradec (faqe 5)
- 13** - Festivali Veror i Ohrit (faqe 6)
- 14** - Balkan Mish-mash, Festivali i Filmit dhe Kulinarisë në Pogradec (faqe 6)
- 15** - Ditët e Fotografisë në Pogradec (faqe 6)
- 16** - Konkurs me ide turistike, rajoni Korçë (faqe 6)
- 17** Aktivitetet e ardhshme dhe Partnerët (page 7)

“ Planeti ynë vështirë të gjendet më, ndaj nuk mund t’ia lejojmë vetes shkatërrimin e tij.

J Potocnik, ish komisioner European për mjedisin

Në vend të parathënies

Vlerësim për projektin e Liqenit të Ohrit në Komitetin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO

Gjatë sesionit të 40 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore, projekti i financuar nga BE dhe Qeveria Shqiptare: “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit” u citua si një model për proceset gjithpërfshirëse, që synojnë të mbështesin përpjekjet e autoriteteve lokale dhe atyre kombëtare për momnimet e reja në Listën e Trashëgimive botërore. Projekti i Liqenit të Ohrit, u vlerësua për komponentët e tij të fortë në ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e integruar, dhe për ndërlidhjen me ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Në bashkëpunim me bordet këshillimore ICROM, ICOMO-s dhe IUCN, janë duke u zhvilluar një sërë aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve lidhur me menaxhimin e integruar, por dhe në fusha të tjera tematike lidhur me to, si: menaxhimi i përbashkët, promovimi i vlerave bazë dhe zhvillimi i qendrushëm i rajonit. Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, agjencitë kombëtare dhe rajonale, homologët maqedonas dhe bordet ICCROM, ICOMOS, IUCN, janë duke punuar së bashku për ta bërë këtë projekt të suksesshëm. Përpjekjet e përbashkëta dhe puna e palodhur morën vlerësime të mëdha në këtë sesion.



BE për projektin

“Ndoshta sfida më e madhe me të cilën po përballlemi në këtë shekull është thelbësisht kjo: si mund të jetojmë dhe të përparojmë së bashku në këtë planet, brenda kornizave të asaj çka na ofron toka jonë? Si mund të sigurojmë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të fitojmë betejën kundër ndryshimeve klimaterike dhe t’u përshtatemi pasojave të tyre, të zhdukim varfërinë dhe të ushqejmë 9 miliardë njerëz pa vazhduar të rëndojmë gjendjen aktuale të degradimit mjedisor dhe shterimit të burimeve? Ne të gjithë e dimë se po të vazhdojmë siç kemi bërë, nuk është zgjidhja e duhur. Por si të lëvizim përpara nga kjo situatë, dhe si të veprojmë sa më shpejt? Vendosija e fokusit në formën e qëndrueshme të zhvillimit është thelbësore, dhe projekti i rajonit të Liqenit të Ohrit, është një nga ato iniciativa me bazë lokale që kërkon përgjigje për këto pyetje urgjente. Zhvillimi i ruajtjes së trashëgimisë dhe turizmit të qëndrueshëm në rajon, përmirëson kushtet e jetës së kësaj zone dhe krijon mundësi punësimi. BE është krenare që kontribuon së bashku me Shqipërinë, për financimin e këtij projekti. Ai është në përputhje të plotë me Planin Kombëtar të Veprimit për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit si dhe mbron dhe nxjerr në pah trashëgiminë kulturore dhe natyrore”.

- Antoine Avignon, Menaxher Programi, Delegacioni i BE në Shqipëri-



Foto nga kursi rreth Liqenit të Ohrit. Foto: @Unesco

Liqeni i Ohrit mirëpriti 20 pjesëmarrës nga 7 vende të Europës Juglindore për të diskutuar se si komunitetet mund të kontribuojnë në trashëgimi dhe si mund të përfitojnë prej saj. Kursi "Promovimi i trashëgimisë me fokus njeriun" - angazhimi i komuniteteve në ruajtjen e Natyrës dhe Kulturës (PCA16) u organizua nga Qendra Ndërkombëtare për studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM) dhe kishte qëllim të informonte praktikantët e trashëgimisë me mjetet e nevojshme për angazhimin e komuniteteve në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.



Kursi u zhvillua në territorin e Shqipërisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Ky kurs i shkurtër fillimisht kishte në fokus praktikantët e trashëgimisë për t'u dhënë atyre njohuritë e nevojshme dhe mjetet për të punuar në mënyrë sa më efektive me komunitetet e grupeve të interesit. Angazhimi i komuniteteve në proceset e ruajtjes dhe menaxhimit ka qëllim të forcojë aftësinë e tyre për të marrë pjesë seriozisht në procesin e marrjes së vendimeve për trashëgiminë rreth tyre. Duke ndjekur suksesin e kursit të vitit të shkuar (PCA15), edhe ky kurs rajonal shfrytëzoi si rast studimi vizitën direktë në pasurinë botërore kulturore dhe natyrore të Liqenit të Ohrit dhe potencialin e tij për zgjerim ndërkufitar. Qëllimi ishte që të nxitej në këtë mënyrë diskutimi dhe debati në terren, duke parë në realitet menaxhimin e kësaj trashëgimie. Çdo pjesëmarrës solli rastin e vet të studimit, ku informacionet, eksperiencat dhe sfidat që kishte hasur secili u ndanë me kolegët nga gjithë rajoni. Trashëgimia mikse natyrale dhe kulturore e Liqenit të Ohrit është shumë rast specifik për të nxitur qasjen e njeriut dhe komunitetit në mbrojtjen e saj. Çështjet rreth ruajtjes dhe menaxhimit të aspekteve kulturore dhe natyrore të këtij rajoni kanë nevojë për një kthesë të jashtëzakonshme gjithëpërfshirëse, pasi kjo ndikon mirëqenien e një vendi dhe të popullatës së tij. Për këtë arsye, pjesëmarrësit e PCA ishin zgjedhur nga sektorët që mbulojnë të dyja këto tipe të trashëgimisë, natyrore dhe kulturore. Pas hapjes së sesionit në Tiranë, ku mikpritëse ishte Ministria shqiptare e Kulturës, pjesëmarrësit zhvilluan kursin në vende të ndryshme rreth gjithë rajonit të Liqenit të Ohrit, duke u njohur me trashëgiminë, por dhe me banorët e zonës. Një vizitë në Muzeun Kom-

bëtar të Shkencave Natyrore "Dr Nikola Nezelovski" në Strugë, i njohu kursantët me lidhjet mes natyrës dhe kulturës. Muzeu ofronte një fotografim të florës dhe faunës unike brenda dhe rreth liqenit të Ohrit. Diskutimet në këtë vend u fokusuan në mënyrën si muzeu mund të kontribuojë më shumë për këtë trashëgimi. Brenda kontekstit historik të qendrës së qytetit të Ohrit, pjesëmarrësit zhbuluan dhe debatuan për përfitimet dhe limitet e sistemeve tradicionale të njohjes së menaxhimit të trashëgimisë. Mjeshtra të rinj të zanave të vjetra shekullore si punimi i filigramit apo i perlës, treguan gjithë pasionin e tyre në ruajtjen e kësaj trashëgimie dhe përcjelljen e saj në breza. Pjesëmarrësit eksploruan Parkun Kombëtar të Galicicas, duke parë nga lart malit një pamje mahnitëse të të gjithë rajonit të Liqenit të Ohrit. Duke u njohur nga afër dhe me lidhjet e forta të banorëve lokalë me këtë territor në shekuj, pjesëmarrësit mësuang gjithashtu dhe për kërcënimet që i vijnë kësaj Trashëgimie Botërore të Liqenit të Ohrit nga projektet zhvillimore të identifikuar tashmë. Duke u zhvendosur në Pogradec, kursantët zhbuluan vlera të fshehura në muzeun e Pogradecit, vizituan pjesën e trashëgimisë së paprekur e qytetit, panë traditën e punuesve të drurit, nallbaneve, dhe prodhuesve lokalë të verës. Mikpritja e ofruar nga gratë e fshatit të Tushemishtit dhe traditat e tyre të kulinarisë ishin momenti më i paharrueshëm i kursit, por dhe kulmi i diskutimeve për përfitimet sociale dhe sfidat që hasen në koordinimin mes sektorëve publikë, civilë dhe privatë për një zhvillim të qëndrueshëm të rajonit. Fshati Lin dhe arkeologjia e tij ishin sfondi më i mirë për të mësuar më shumë rreth mënyrave të angazhimit të komunitetit në faza të ndryshme të procesit pjesëmarrës: nga marrja e informacionit deri te vendimmarrja. Në vendqendrimin piktoresk dhe të qetë të gadishullit të Linit, pjesëmarrësit punuan së bashku në grupe për të bërë rekomandime për të ardhmen e komunitetit të angazhuar në ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore të Liqenit të Ohrit. Gjatë prezantimeve publike të mbajtura në pallatin e Kulturës Pogradec, në mbyllje të kursit, konkluzionet e pjesëmarrësve u fokusuan në atë se si të sigurohet që trashëgimia mund të kontribuojë në një zhvillim më të qëndrueshëm të rajonit, duke garantuar që përfitimet të shkojnë për të dy palët si për komunitetin lokal por dhe për vetë trashëgiminë. Partnerët në realizimin e këtij kursi ishin ICCROM, IUCN, ICOMOS dhe Qendra e trashëgimisë botërore të UNESCO, por dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës së Shqipërisë si dhe Zyra për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Ministrisë Maqedonase të Kulturës.



Propozim për të ruajtur ndërtesat tradicionale rreth liqenit të Ohrit

Ruajtja dhe mbrojtja e zonës së zhvilluar të trashëgimisë në Pogradec është thelbësore për gjithë autoritetet lokale të pjesës shqiptare të Liqenit të Ohrit. Në këtë kuadër, Këshilli Kombëtar për Monumentet dhe Vendet (ICOMOS) propozon zhvillimin e një manuali me udhëzime për ruajtjen dhe rehabilitimin e ndërtesave tradicionale të trashëgimisë, në pjesën shqiptare të rajonit. Manuali do të adresojë problemet e ruajtjes së tyre dhe nevojat për përmirësim të kësaj trashëgimie në pjesën shqiptare të liqenit, duke ruajtur dhe mbrojtur morfologjinë e tyre dhe karakteristikat e materialet e ndërtimit. Udhëzuesi do të shërbejë si një mjet reference për gjithë ata që janë përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së zhvilluar në zonën e Pogradecit, përfshi arkitektët lokalë, inxhinierë dhe artizanë. Gjithashtu do jetë i vlefshëm dhe për institucionet shtetërore dhe administratën lokale. Misioni vëzhgues i ICOMOS në këtë zonë, i kryer në qershor 2015, ka theksuar nevojën për racionalizimin e mjedisit të ndërtimeve dhe përmirësimin e cilësisë dhe performancës së aseteve të ndërtuara në pjesën shqiptare të rajonit të liqenit të Ohrit. Ky udhëzues për ndërtesat e trashëgimisë do të përpilohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve, Drejtorinë rajonale për trashëgiminë kulturore dhe bashkinë e Pogradecit. Stafi nga institucionet shqiptare do të përfshihet gjithashtu në zhvillimin e këtij udhëzuesi, në mënyrë që ai të përpilohet gjithashtu edhe për zona të tjera të trashëgimisë në Shqipëri. Gjithashtu parashikohet dhe shkëmbim njohorish me partnerët e institucioneve maqedonase. Udhëzuesi planifikohet të publikohet në vjeshtë 2017. Ka disa botime të ngjashme për vende të tjera të trashëgimisë si Cinqueterre në Itali, Jeddah në Arabë Saudite, Jeruzalem e Gjirokastër.



Broshurat e ICOMOS

Mbështetja e Menaxhimit të duhur të mbetjeve në Bashkinë e Pogradecit

Qëllimi i përbashkët i partnerëve të mbledhur rreth projektit "Drejt një qeverisje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit", është të mbështesin përpjekjet e autoriteteve lokale dhe kombëtare për të ruajtur trashëgiminë unike kulturore dhe natyrore të rajonit të Liqenit të Ohrit. Një nga sfidat kryesore përpara, është përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve solide në këtë zonë.

Nën anën shqiptare të Liqenit, menaxhimi i mbetjeve solide është renditur si prioritet dhe në Planin Kombëtar dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve për vitet 2010-2025. Në mënyrë që të bëhen hapat e parë në adresimin e kësaj çështjeje, ekipi ka krijuar një strukturë qeveritare, ka identifikuar përfaqësuesit e konsorciumit, qeverisë lokale dhe çdo grup tjetër interesi lokal. Në qershor 2016, IUCN mbështeti formimin e një konsorciumi që mbloshi Qendrat e Zhvillimit Rural dhe Kombëtar për Mjedisin nga Tirana dhe ato të



Zhvillimit e Qëndrueshmërisë së Turizmit nga Pogradeci. Detyra e tyre e parë ishte të përgatitej Plani Lokal i Veprimi për Menaxhimin e Integruar të mbetjeve për Bashkinë e Pogradecit për periudhën 2017-2023. Plani do të mbështesë politikën lokale dhe planifikimin për një sistem të integruar të menaxhimit të mbetjeve në rajonin e Pogradecit, duke patur në plan dhe një vend të ri rajonal për landfill në Maliq, rajonin e Korçës. Bazuar në vlerësimin e situatës aktuale të menaxhimit të mbetjeve në bashkinë e Pogradecit, drafti i parë i dokumentit u prodhua në shtator 2016 dhe tashmë është rishikuar nga qeveria lokale. Si hap të metejshëm, konsorciumi do të asistojë qeverinë lokale të Pogradecit në kryerjen e një konsultimi publik të draftit që do të jetë subjekt i Vlerësimit strategjik Mjedisor. Përveç kësaj, një fushatë për ndërgjegjësimin e publikut për mbetjet do të shpëtojë punën e ndërmerret në nivel politik. Aktivitetet e ndërgjegjësimi që do të ndërmerren do të nisin në Nëntor 2016.

Takimi ndërkufitar në Strugë adreson menaxhimin e përbashkët të Liqenit të Ohrit

Takimi ndërkufitar për Liqenin e Ohrit u zhvillua në 27-28 tetor në Strugë, Ish republikën Jugosllave të Maqedonisë. Takimi u organizua në kuadër të projektit "Drejt një qeverisje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit", financuar nga BE dhe qeveria shqiptare. Kjo platformë ndërkufitare forcon sinergjitë mes strukturave ndërkufitare të menaxhimit, siç është Sekretariati i Përbashkët i Komitetit të Menaxhimit të basenit Ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit, dhe iniciativat e tjera si Shpallja 'Njeriu dhe Biosfera e Unesco'. Këto struktura ndihmojnë që të forcohet menaxhimi i rajonit të Liqenit të Ohrit në të dy vendet. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria maqedonase e Mjedisit dhe planifikimit fizik dhe Ministria e Kulturës, përfaqësues nga Agjencia kombëtare për Zonat e Mbrojtura, Anëtarë të sekretariatit të përgjithshëm të Komitetit ndërkufitar të Basenit Ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit dhe kryebashkiakët e Strugës dhe Pogradecit, si dhe përfaqësuesit nga qeveritë lokale të Ohrit. Pjesëmarrësit ishin në një mendje se projekti i rajonit të Liqenit të Ohrit po zbatohet në mënyrë të kënaqshme, dhe se gjithë çështjet e planifikuara janë adresuar brenda zbatimit të projektit. Sidoqoftë është rënë dakord se disa aktivitete duhet të shpejtohen në mënyrë që të arrihen afatet e kërkuara. Bëhet fjalë veçanërisht për finalizimin e Planit të Menaxhimit për Dosjen e



Takimi ndërkufitar dhe Qyteti i Strugës @Unesco

Nominimit si Trashëgimi Botërorë për zonën e propozuar për t'u zgjeruar. Gjithashtu u diskutuan hapa të tjerë të projektit që synojnë të arrijnë sinergji më të mëdha dhe përputhje mes planeve të menaxhimit për Pasurinë aktuale të Trashëgimisë botërore dhe asaj që do të zgjerohet, dhe për të promovuar sa të jetë e mundur, një udhëtim të përbashkët për proceset zbatuese dhe implementuese. U ra dakord që:

- Strukturat menaxhuese të kenë strukturë operacionale dhe funksionale

- U diskutuan pikat e dobëta dhe të forta të Komitetit të Basenit Ujëmbledhës, shqetësimi kryesor që i takon këtij komiteti është rënë dakord që dy vendet do të shkëmbejnë draftet e përpunuara të Planeve të Menaxhimit, në mënyrë që të sigurojnë harmonizimin e veprimeve për pasurinë e zgjeruar. Në përputhje me këto, tema e takimit të ardhshëm të pestë të platformës ndërkufitare duhet të fokusohet në harmonizimin e dy planeve në mënyrë që të sigurojë që strukturat operacionale janë të afta të menaxhojnë pasurinë e përbashkët sapo ajo të listohet. Drafti i Planit të Menaxhimit për pasurinë tashmë të listuar në Trashëgiminë Botërore, është përpunuar nga Ministria e Kulturës e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, por nuk janë bërë ende komente mbi këtë plan nga bashkitë e Strugës dhe Parku Kombëtar i Galicicas. Rekomandohet fort që Ministria të ridërgojë një kërkesë për plotësimin e komenteve të këto dy entitete dhe të sigurohet futja e komenteve të tyre në draft. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të GIZ gjithashtu u mirëprit në këtë takim, gjithashtu edhe angazhimi i tyre aktiv në rivitalizimin e Komitetit të Pellgut Ujëmbledhës dhe strukturave të Republikës së Shqipërisë të lidhura me menaxhimin e liqeneve të Ohrid, Prespës dhe Shkodrës.

Shqipëria pranohet në Konventën Europiane të Peisazhit



Parlamenti shqiptar

Parlamenti Shqiptar ka miratuar më 8 shtator 2016, ligjin "Për pranimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Peisazhit". Konventa është miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në 1 qershor 2000. Deri tani, 38 shtete e kanë ratifikuar këtë konventë, midis të cilëve shumë shtete të BE-së si Danimarka, Belgjika, Franca, Greqia, Italia, Spanja, Anglia dhe Suedia. Objektivi kryesor i kësaj konvente është të bëjë hapa përpara në planifikimin dhe menaxhimin e peisazheve, të rrisë bashkëpunimin në nivele rajonale dhe ndërkombëtare në këtë fushë dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve në zonat urbane dhe rurale. Ky ligj është në përputhje të plotë me axhendën e qeverisë shqiptare që konsideron mbrojtjen e mjedisit si një komponent të rëndësishëm për politikën e tij, dhe si një përpjekje të përbashkët me qytetarët e saj, organizatat mjedisore, shoqërinë civile, shkollat mediat, institucionet shkencore dhe sektorin privat. Përmirësimi i situatës në menaxhimin e peisazheve, marrja e masave të përshtatshme për të ruajtur zonat e mbrojtura dhe ndotja e mjedisit janë problemet dhe sfidat kryesore të qeverisë shqiptare. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj konvente është krijimi i procedurave për përfshirjen e komunitetit në procesin e dhënies të informacionit vendimarrjes dhe rritjes së ndërgjegjësimit të shoqërisë civile dhe OJF-ve. Gjithë grupet e interesit duhet të planifikojnë menaxhimin e peisazheve të tyre dhe të kuptojnë vlerat dhe rolin e tyre në jetët e gjithsecilit.

Opsioni 1- Forcimi i Komitetit të Basenit Ujëmbledhës, rivitalizimi i i strukturës

Opsioni 2- Amendimi i marrëveshjes 2004, me përcaktim të qartë të termave të referencës, për këtë organizim, për të menaxhuar çështjet ndërkufitare të pasurisë së zgjeruar. Është rënë dakord që dy vendet do të shkëmbejnë draftet e përpunuara të Planeve të Menaxhimit, në mënyrë që të sigurojnë harmonizimin e veprimeve për pasurinë e zgjeruar. Në përputhje me këto, tema e takimit të ardhshëm të pestë të platformës ndërkufitare duhet të fokusohet në harmonizimin e dy planeve në mënyrë që të sigurojë që strukturat operacionale janë të afta të menaxhojnë pasurinë e përbashkët sapo ajo të listohet. Drafti i Planit të Menaxhimit për pasurinë tashmë të listuar në Trashëgiminë Botërore, është përpunuar nga Ministria e Kulturës e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, por nuk janë bërë ende komente mbi këtë plan nga bashkitë e Strugës dhe Parku Kombëtar i Galicicas. Rekomandohet fort që Ministria të ridërgojë një kërkesë për plotësimin e komenteve të këto dy entitete dhe të sigurohet futja e komenteve të tyre në draft. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të GIZ gjithashtu u mirëprit në këtë takim, gjithashtu edhe angazhimi i tyre aktiv në rivitalizimin e Komitetit të Pellgut Ujëmbledhës dhe strukturave të Republikës së Shqipërisë të lidhura me menaxhimin e liqeneve të Ohrid, Prespës dhe Shkodrës.

Intervistë me Milovan Shutinoski

Drejtori i Muzeut "Nikola Nezlobinski" në Strugë flet për këtë vend të veçantë



Milovan Shutinoski

Muzeu Nikola Nezlobinski në Strugë zë një vend shumë të rëndësishëm në historinë e rajonit të Liqenit të Ohrit, pasi prezanton jo vetëm Liqenin, por gjithë speciet e tij gjatë një periudhe më shumë se 100 vjeçare. Muzeu ruan dhe ekspozon specie të kafshëve dhe bimësinë e gjithë rajonit të Liqenit të Ohrit dhe të Prespës. Është një koeksion i rrallë pasi shumë specie nuk ekzistojnë sot. Themeluesi i këtij Muzeu ishte doktori rus Nikola Nezlobinski, një adhurues i natyrës. Ai erdhi në Strugë për të ndihmuar në luftimin e epidemisë së malarisë në 1924. Porsa mbërriti në Strugë nisi të koleksionojë dhe të ruajë insekte, zogj dhe lloje të tjera kafshësh. Në 1928 ai krijoi ekspozitën e parë zoologjike dhe duke bërë këtë ai vuri dhe themelet e muzeut të shkencave natyrore në Strugë. Ekspozimi aktual në muze përcaktohet nga origjina e faunës dhe florës, të cilat që të gjitha vijnë nga malet dhe fushat rreth rajonit të Strugës-Ohrit, duke shfaqur dhe karakterin lokal të këtij institucioni të specializuar shkencor. Ekspozimi konsiston në një numër insektesh, amfibësh, zvarranikësh, dhe specie peshqish që jetojnë në Liqenin e Ohrit, si dhe shumë zogj dhe specie gjitarësh nga i gjithë rajoni. Evoluimi i jetës demonstron në këtë muze me kategoritë e kafshëve duke nisur që nga format më primitive të gjitarëve dhe zogjve. Muzeu Nikola Nezlobinski është një institucion kombëtar që konsiston në 5 ndarje të ndryshme ose departamente: biologji, arkeologji, etnologji, histori dhe art. Drejtori aktual i këtij muzeu është Milovan Shutinoski, të cilin ne e intervistuar për të mësuar më shumë rreth këtij vendi të veçantë.

A mund të na përshkruani me pak fjalë rëndësinë e Muzeut të Strugës për mbrojtjen vlerave të Liqenit të Ohrit?

Koleksioni unik që muzeu përfaqëson, si për trashëgiminë kulturore dhe atë natyrore, janë shembulli më i mirë i faktit se si natyra dhe njerëzit kanë jetuar pranë e pranë për shekuj të tërë. Vlerat e rajonit të liqenit të Ohrit prezantohen për gjithë njerëzit që e vizitojnë këtë muze. Këtu kanë një mundësi për të mësuar më shumë për historinë e rajonit. Ju mund të shihni se çfarë kemi arritur të ruajmë, por gjithashtu se çfarë është humbur, pasi shumë ndryshime kanë ndodhur në thellësitë e Liqenit të Ohrit prej vitesh.

Cila është pjesa më delikate që kërkon më shumë punë për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të muzeut?

Çdo ditë për ne është një sfidë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë natyrore dhe kulturore që muzeu përfaqëson. Ne punojmë me hapësira të kufizuara, në të cilat duhet të prezantojmë këtë trashëgimi natyrore dhe kulturore të rajonit dhe muzeu ka shumë e shumë objekte në magazinat e tij që ende duhet të prezantohen për publikun dhe të mbrohen siç duhet.

Bazuar në kërkimet tuaja, rajoni i Liqenit të Ohrit po i humb apo po i ruan vlerat e veta të vjetra?

Fatkeqësisht shumë vlera që rajoni i Liqenit të Ohrit i posedon, janë të kërcënuara, jo vetëm sot, por në mënyrë konstante. Ndërhyrja nga njerëzit është kërcënimi më i madh për këtë trashëgimi. Sidoqoftë nga ana tjetër ka disa veprime pozitive që janë ndërmarrë për të ruajtur vlerat e rajonit të liqenit të Ohrit. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për thesaret që ky rajon ka, është qëllimi kryesor që duhet arritur në mënyrë që ta mbrojmë dhe ta ruajmë atë.

A kenë në muze disa gjetje nga pjesa shqiptare e Liqenit të Ohrit? Cili është mesazhi tuaj për kolegët e pjesës tjetër të liqenit?

Koleksioni unik i florës dhe faunës në muzeun tonë të shkencave natyrore përfaqëson Liqenin e Ohrit si i tërë, një liqen. Peshqit dhe zogjtë nuk njohin kufij, dhe trashëgimia e pasur kulturore ekziston dhe në anën tjetër të liqenit të Ohrit. Gjithë njerëzit, veçanërisht ata të përfshirë në trashëgiminë kulturore dhe natyrore, duhet të punojnë shumë fort për të ruajtur dhe mbrojtur vlerat e tij, që gjithë bota ta njohë si diçka shumë speciale. Ne duhet të punojmë së bashku për të mbrojtur këto vlera, pasi rajoni ynë i Liqenit të Ohrit është i veçantë dhe i rëndësishëm.



Pjesëza nga Muzeu i Struges

Mbrëmjet e Poezisë në Strugë



Margaret Atwood duke mbjellë pemën e saj në Parkun e Poezisë, Strugë

Atwood, fituesja e "Kurorës së Artë mbjell pemën e saj në Parkun e Poezisë në Strugë

Margaret Atwood, poetja dhe shkrimtarja 76 vjeçare kanadeze është fituesja e Kurorës së Artë të këtij viti në "Mbrëmjet e Poezisë" Strugë. "Jam shumë e surprizuar dhe e lumtur që u zgjodha për Kurorën e Artë të këtij viti dhe veçanërisht edhe më e lumtur që të marr pjesë në Mbrëmjet e Poezisë Strugë. Ju faleminderit që e përkthyet poemën time në gjuhën tuaj. Është një përpjekje heroike. Ne poetët duhet t'u jemi mirënjohës përkthyesve, - tha Atwood në hapjen e festivalit. Ajo pasi falenderoi për çmimin, lexoi për të pranishmit poemën e saj "Sekretet". Atwood theksoi se në një periudhë të shkurtër në Strugë, ajo u ndje e mrekulluar nga mikpritja e ngrohtë dhe bisedat e këndshme me banorët e saj. Shkrimtarja kanadeze mbolli një pemë në Parkun e Poezisë në Strugë. Çdo vit fituesi i festivalit ka nderin të mbjellë një pemë në Parkun e Poezisë Strugë. Kjo është një traditë e madhe që tregon se si pemët dhe librat jetojnë së bashku dhe plotësojnë njëra tjetrën. Qyteti i poezisë dhe urave, qyteti i vëllëzerve Mladinov, për të 55-in vit rresht ka rritur reputacionin e tij si kryeqyteti i poezisë. 32 poetë nga 30 vende, si Kanada, Itali, Australi, Emiratet e Bashkuara Arabe, Turqi, Belgjikë, Izraeli, Hungari, Kinë, Kolumbi, Meksikë, Spanjë, Francë, Irlandë, Indi, Bullgari, Shqipëri, Argentinë, Brazil, Kroaci, Gjermani, Lituan, Marok, Palestinë, Poloni, Serbi dhe Sllovakia, dhe 20 poetë nga Maqedonia morrën pjesë në këtë edicion jubilee të Mbrëmjeve të Poezisë në Strugë.



Festivali i 55-të i Mbrëmjeve të Poezisë në Strugë

Eksplorimi nënujor i Liqenit të Ohrit



Me bicikletë rreth Liqenit të Ohrit. Foto: Ivana Dervishi

Me biçkletë 360 gradë rreth liqenit më të thellë në Ballkan


Liqeni i Ohrit është një aventurë e vërtetë për ata që dashurojnë të udhëtojnë me biçkletë dhe për të gjithë ata që duan të shijojnë pamje 360 gradë të liqenit të Ohrit. Është një aventurë fantastike që kombinon turizmin kulturor me turizmin aktiv dhe udhëtimin me biçkletë. Ivana Dervishi është një gazetare e apasionuar pas udhëtimit dhe të shkruarit. Ajo ka zgjedhur për t'i rënë rreth e qark liqenit të Ohrit mbi dy rrota. Mbi të gjitha i pëlqen ideja e të udhëtuarit me biçkleta përmes dy shteteve. Liqeni i Ohrit është pjesa lindore më e bukur e Shqipërisë dhe gjithashtu një magnet për turistët në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Distanca totale rreth liqenit të Ohrit është përafërsisht 100 km. "Mund të zgjidhni ta bëni udhëtimin në një ditë apo dy, duke përfshirë një natë fjetje në Pogradec ose në Ohër. Sigurohuni të keni ujë dhe ushqim me vete për t'i konsumuar gjatë pushimeve të shkurtra. Mund të filloni udhëtimin nga Pogradeci drejt Tushemisht. Liqeni i Ohrit ndodhet në të majtën tuaj dhe nuk ju humbet nga sytë gjatë 12 km deri në pikën kufitare. Një kontroll pashaporte dhe më pas je i lirë të vazhdosh pedalin", - thotë ajo. Pasi kalon kufirin në Tushemisht, era e Parkut Kombëtar të Galicicës dhe pamja e qetë e liqenit të Ohrit ju shpalos bukuritë në të gjitha dimensionet: liqenin e keni në pëllëmbë të dorës. Pas një ngjitje të ngadaltë në mal, do të zbrisni në Trpejca dhe Peshtan, duke u mbushur me adrenalinë. Pas 40 km do të arrini në qytetin e bukur të Ohrit, një qytet mbushur me turistë. Udhëtimi 15 km për në Strugë të duket i thjeshtë, përgjatë një rruge dytësore të rrethuar me pemë të larta e ndërsa meditonit për udhëtimin, shihni nga afër kallamishtet e shumta të ngulura në liqen. Drin i Zi që rrjedh përmes Strugës është gjithashtu një vend i mirë për t'u relaksuar, për një kafe të shkurtër ose për të ngrënë diçka të lehtë. Rruga drejt Shqipërisë sa vjen e bëhet më malore, arrin deri në 1000 metra lartësi në nivelin e detit. Kjo është pjesa më e vështirë e udhëtimit. Procedurat e kontrollit mbarojnë shpejt dhe ti e gjen veten menjëherë në tokën shqiptare. Zbritja në Qafën e Thanës drejt Linit kërkon eksperiencë ciklistike dhe frenat të mira. Dhe ja ku shfaqet sërish panorama e liqenit të Ohrit. 10 kilometrat e fundit për në Pogradec janë relaksuese; është afër finishit dhe përgjatë rrugës së sapo rikonstruuar pamja e liqenit të Ohrit nuk ndërpritet asnjëherë. Një darkë në Drilon do të ishte një mbyllje ideale e udhëtimit 100 kilometra rreth liqenit më të thellë në Ballkan. Do të lodheni, por do të jeni të mbushur me kujtimet e magjishme të Liqenit, të zogjve, mjelmave, varkave, njerëzve dhe gjithë trashëgimia e shtrirë në të dyja anët kufitare.

Zhytësit adhurojnë të eksplorojnë Liqenin e Ohrit, një nga liqenet më të thella në Europë dhe një ndër më të lashtit. Aventurierët mund të gjejnë thesare të vërteta arkeologjike në fundin e liqenit. I njohur për biodiversitetin e tij, liqeni i Ohrit ka shfaqur historinë e tij të fshehur. Zhytësi maqedonas Milutin Sekuloski ka zbuluar mbetjet e vendbanimit të Epokës së Bronzit në thellësitë e liqenit të Ohrit. Ai është një instruktor zhytje në qendrën "Amfora Diving" dhe ndihmon të tjerët të zhyten në thellësitë e liqenit të Ohrit. "Përse shumë turistë duan të zhyten këtu? - Për të parë objekte autentike të vendbanimeve prehistorike që datojnë para 3, 200 vjetësh. Shumica e tyre duan të bëjnë foto dhe video brenda në ujë", - thote Milutin për Euronews. Turistët mund të vizitojnë fshatin e rindërtuar rreth Liqenit dhe mund të bëjnë zhytje për një orë për të gjetur pjesë qeramike të lashta, kocka, mjetet dhe madje edhe stoli në basenin e tij.

Një tjetër zhytës, Tomasz Pezold, i cili punon për IUCN në projektin për rajonin e liqenit të Ohrit, ndan me ne përvojën e tij në zhytje me ekipin e Millutin. "Edhe pse nuk është aq spektakolare sa i përket ngjyrave dhe biodiversitetit, që gjenden në detet tropikale, një zhytje në Liqenin e Ohrit është një eksperiencë unike. Duke parë nga afër përmes ujit kristal, zbulon krijesa ujore të cilat nuk mund të shikohen aq mirë në organizmat e tjera të ujërave të ëmbla. Mundësia për të parë mbetje arkeologjike sjell një bukuri historike që e çon zhytjen në një tjetër dimension. Një eksperiencë e tillë për vizitorët e ndryshëm duhet të planifikohet të futet edhe në anën shqiptare të liqenit", tha Tomasz. Euronews transmetoi disa pamje të mahnitshme nga thellësitë e liqenit më të vjetër në Europë, që tregon pasurinë e faunës dhe florës së liqenit të Ohrit, por edhe historinë e tij.

Reportazh nga Euronews në 19 Shtator 2016.

Fosilet e peshqve të Pogradecit



Belushka dhe Korani

Nëse një liqen është 4 milion vjeçar, atëherë banorët në ujërat e tij të lashtë duhet gjithashtu të jenë të lashtë dhe unik. Korani dhe Belushka janë dy lloje peshqish që janë të veçantë për liqenin e Ohrit dhe mund të gjenden lehtë në zonën e Pogradecit, në anën shqiptare. Blogeri Aurélien Rateau ka shkruajtur një artikull interesant në HuffingtonPost.fr për një udhëtim që ka bërë në Pogradec. Ai kishte kaluar një pjesë të ditës me peshkatarët



Restaurant in Pogradec

lokal përgjatë liqenit, duke vëzhguar si ata kapin peshqit dhe më pas ua shesin restoranteve. Kjo është e vetmja mënyrë që të fitojnë para dhe të sigurojnë jetesën. Për peshkatarët është fitimprurëse, por jo për peshqit, të cilët janë unik për liqenin e Ohrit. Megjithatë, Pogradeci jeton prej turizmit. Shqiptarët vijnë të kalojnë fundjavat dhe pushimet në ujërat e

pastra kristal të liqenit. Ata përfitojnë nga plazhi dhe nga shëtitorët dhe në mënyrë të pashmangshme shkojnë në një restorant për të shijuar koranin dhe belushkën. Korani, Salmo letnica (në latinisht) është mbretëresha e liqenit. Hulumtimi i fundit gjenetik ka zbuluar që ky peshk është pjesë e kategorisë së trofës kafe, i ndarë nga paraardhësit e tyre të përbashkët, para pak më shumë se një milion vjet më parë. Belushka, Salmo ohridanus, është më misterioze. Ky peshk, i përket familjes së Salmonit dhe ka 4 milionë vjet histori. Ajo dëshmon për moshën respektive të liqenit dhe mund të përshkruhet si një specie fosile. Situata me Belushkën, e cila nuk ndihmohet nga riprodhimi artificial, është akoma më kritike se për Koranin. Ajo që është krijuar në miliona vjet është shkatërruar në pak vite, ku ky peshk e gjen veten të kërcënuar në habitatin e tij unik, liqeni i Ohrit. Blogeri e mirëkupton jetën e këtyre fshatarëve të varfër të Pogradecit, që jetojnë me ato që u sjell liqeni, por Z. Rateau është i shqetësuar për ruajtjen e specieve unike që jetojnë në thellësitë e liqenit të Ohrit.

Blog nga Aurélien Rateau në Huffington Post. 5 Tetor 2016



Festivali Veror i Ohrit

Festivali Veror i Ohrit është event i më i madh kulturor në pjesën maqedonase të liqenit të Ohrit. Edicioni i 56 këtë vit u hap më 12 korrik 2016 me një koncert Gala, dhe zgjati deri 20 gusht 2016. Festivali prezantoi koncerte klasike dhe opera, teatro dhe valle, duke udhëtuar në vende të ndryshme të qytetit. Drejtori i Festivalit Oliver Arsovski, një muzikant që gjithashtu ka performuar më parë në këtë festival, e konsideron Festivalin Veror të Ohrit si një nga eventet më prestigjioze kulturore jo vetëm në Maqedoni por dhe në gjithë rajonin dhe më gjërë. Shumë aktivitete artistike u mbajtën në

Ohër kur ky qytet i bukur ishte i mbushur me turistë. Kjo traditë e ka origjinën nga përcaktimi i Ohrit si qendra shpirtërore e Maqedonisë, një qytet antik me liqenin magjik blu, një qytet me histori kulturore të shenjuar me vlerat e civilizimit antik, një qytet që përfaqëson gjithë historinë kulturore dhe shpirtërore të rajonit. Festivali Veror i Ohrit u mbajt për herë të parë në 4 gusht 1961, në katedralen e bukur të Shën Sofisë. Pas disa viteve të rizbulimit të vetes dhe kornizimit të karakterit të tij, ky festival përfundimisht e ka përcaktuar veten si një nga shtyllat e traditës kulturore maqedonase

Konkurs idesh turistike për Korçën dhe Pogradecin



Ministria Shqiptare e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Agjencia shqiptare e zhvillimit të investimeve Aida me mbështetjen e Projektit Risi Albania ka lançuar edicionin e tretë të Konkursit Risi Turistike. Këtë herë konkursi është për zonën e Korçës për të nxitur zhvillimin e produkteve të reja turistike. Korça është bashkia që përfshin qytetin e Pogradecit, i cili ndodhet në brigjet e Liqenit të Ohrit, më i thelli dhe më i vjetri në Europë. Produktet inovative të turizmit do të ndihmojnë në krijimin e produkteve dhe itinerareve të reja, ose të shtojnë vlerë te ato ekzistuese duke ofruar një eksperiencë më të pasur dhe autentike për turistët në dy fushat. Janë inkurajuar më shumë për të aplikuar të rinj me ide inovative që mund ta bëjnë ofertën turistike në Liqenin e Ohrit më diverse dhe dinamike. Fituesit e konkursit do të njoftohen në Dhjetor 2016. Konkursi konsiderohet një mundësi e mirë që mund të sjellë ide të reja turistike për Liqenin e Ohrit. Vlen të theksohet se produkti turistik në Pogradec është ende në fazat e para dhe ka nevojë për zhvillim, por duke ruajtur vlerat më të mira të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Festivali i Filmit dhe Kulinarisë në Pogradec



Festivali i Filmit dhe Kulinarisë, Balkan Mish-Mash Film Production u mbajt në Pogradec nga 31 korrik deri në 5 Gusht 2016. Ky festival këtë vit u bë i mundur falë mbështetjes së UNESCO. Mbi 150 filma nga vendet ballkanike morën pjesë në këtë edicion të festivalit. Një seksion i ri-Trashëgimia ballkanike- iu shtua zhanreve të tjera të konkurimit. Dokumentarë që kanë të bëjnë me traditën e Ballkanit, kulturën, muzikën dhe natyrën ishin pjesë e festivalit duke na mundësuar të gjithëve njohjen e asaj që gjithë ballkanasit kanë të përbashkët, si dhe atë që i bën unike vendet e këtij rajoni. Festivali mbahet çdo vit në Pogradec, një zonë e njohur historikisht për rëndësinë dhe rrugët e saj tregtare mes vendeve të tjera të Ballkanit që në shekujt e perandorisë Osmane. Filmi më i mirë që u shpall si fitues i festivalit titullohet: "Dua të lahem në shi", me regji të Gulten Taranc nga Turqia. Filmi më i mirë eksperimental ishte: "Kemi qenë këtu gjithmonë" nga Peter Cerovšek, Neža Grum, Matevž Jerman (Slovenia); Animacioni më i mirë: "Darkë për pak vetë" nga Nassos Vakalis Greece; Komedia më e mirë: "Të shëndoshesh në mënyrë të shëndetshme" nga Kevork Aslanyan (Bulgaria). Shpirti më i mirë ballkanik: "Vëzhgoj", nga Mark Sargent (Greqi). Festivali i Filmit dhe Kulinarisë nuk është thjesht festival për traditën ushqimore dhe të gatimit. Ai është gjithashtu festival për prodhimin e filmit. Qëllimi i festivalit është të krijojë një klimë mirëkuptimi, miqësie e bashkëpunimi mes vendeve të Ballkanit.

Ditët e fotografisë në qytetin e Pogradecit



Jeta në brigjet e liqenit të Ohrit të frymëzon të bëhesh shkrimtar, fotograf ose piktor. Fotografia dhe piktura konsiderohen si poezi e heshur. Një foto vlen sa një mijë fjalë, dhe ja përse aktiviteti më i shpeshtë në zonën e Pogradecit janë ekspozitat, me piktura dhe foto, të gjitha me fokus Liqenin e Ohrit. Ditët e Fotografisë në Pogradec ishte një iniciativë e mbajtur në

29 tetor, për të dytin vit rresht. Kjo ekspozitë solli disa punë të mrekullueshme të ndoshta fotografëve më të mirë të Shqipërisë. Fotografia më e njohur i Liqenit të Pogradecit, Ardian Fezollari ishte dhe organizator i eventit. 22 artistë profesionistë nga qytete të ndryshme të Shqipërisë morën pjesë në këtë aktivitet më fotot e tyre më të mira të vitit. Qëllimi i aktivitetit ishte të tregonte fotot më të bukura të vitit në një dhomë të vetme. Natyra, njerëzit dhe liqeni ishin kapur nga këndvështrime të ndryshme, duke shfaqur jo vetëm personalitetin artistik të autorëve, por dhe realitetin dhe panoramën e peisazhit të bukur



të Shqipërisë, veçanërisht imazhin paqësor të Liqenit të Ohrit. Nuk ishte thjesht ekspozitë, por një forum për të ndarë idetë mes fotografëve profesionistë dhe për të shpejguar punët e tyre të bukura. Mesazhi ishte: Ska rëndësi nëse je piktor, fotograf apo poet, lëre Liqenin e Bukur të Ohrit të të inspirojë për të arritur maja më të larta krijuese

Liqeni i Ohrit Dy shtete, një Liqen



Speciet e Liqenit të Ohrit. Foto: Noldi Shaho



Fshati i Linit filmuar me dron. Autori: Michael Hussey

partnerët



UNESCO
Qendra e Trashëgimisë Botërore-
koordinatore e Projektit



Bashkimi Europian-
Kontribuesi Kryesor Financiar



Ministria e Mjedisit
e Republikës së Shqipërisë



Ministria e Kulturës
e Republikës së Shqipërisë



Ministria e Kulturës e ish
Republikës Jugosllave të Maqedonisë



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Fizik
të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë



ICROM
(Qendra Ndërkombëtare për Studimin e
Ruajtjes dhe restaurimit të Pasurisë Kulturore)



ICOMOS
(Këshilli Ndërkombëtar mbi Monumentet e Vendet)



IUCN
(Unioni Ndërkombëtar për ruajtjen
e Natyrës)

Kalendari

Aktivitete të ardhshme

6-8 dhjetor 2016 - Trajnim mbi
Ruajtjen dhe menaxhimin e
Ekosistemit të rajonit të Liqenit të
Ohrit

Pranverë 2017- Konkurs
fotografie në mediat sociale
“Dimër 2016-2017”

Pranverë 2017 - Trajnim:
Zhvillimi i sipërmarrjes së
qendrushme

Pranverë 2017- takimi i 5 i
Platformës ndërkufitare Pogradec

Mbrojtja e Liqenit të Ohrit

Kjo është një gazetë e publikuar nga Projekti :Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit.

Gjuhët: Anglisht, Shqip, Maqedonisht. Bashkimi Europian nuk është përgjegjës për përmbajtjen e kësaj gazete

Në numrin tjetër: Aktivitete të projektit, Turizmi rreth liqenit të Ohrit, Konkurs fotografie në Mediat sociale etj...

Faqja e projektit: <http://whc.unesco.org/en/lake-ohrid-region>

Twitter: https://twitter.com/lake_ohrid

Facebook: <https://www.facebook.com/LakeOhridHeritage/>

Blog: <http://lakeohrid.blogspot.al/>

Per komente/suggjerime email: a.fiebig@unesco.org

Copyright: UNESCO